



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRRREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR 2010

Prishtinë
mars 2011

Vizioni

“Shërbime cilësore, dhe të qëndrueshme të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Kosovës.”

Misioni

“Të bëjë Rregullimin e kompanive të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikën e mira Evropiane, veçanërisht duke u fokusuar në promovimin e efikasitetit, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve, me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	3
1. PARATHËNIE	4
2. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM	6
2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM	6
2.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM	6
2.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM	7
2.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM	9
3. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUM	10
3.1. LICENCIMI	10
3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS	15
3.2.2 PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMPANIVE RAJONALE TE UJESJELLESIT	16
3.3.1. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave	26
3.3.3. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit	28
3.3.4. Të dhënat për shpenzimeve operative	28
3.3.5. Të dhënat për investimet kapitale vetanake dhe nga donatorët	29
3.3.6. Pasqyra e tarifave të përcaktuara tre vjeçare 2009-2011	30
3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE	32
3.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit	32
3.4.2. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve përmes KKK-ve	32
Tabela 25. Numri i Ankesave të Zgjedhura nga KKK	34
4. AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL	35
4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV	35
4.2. MBËSHTETJA INSTITUCIONALE NGA DONATORËT	37
5. RELACIONET E JASHTME	38
5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË	38
5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EUROPË	40
5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN	40
6. ASPEKTET FINANCIARE	40
6.1. SHPENZIMET	40
6.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT	41
6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2010	41

1. Parathënie

Kam kënaqësinë e veçantë që përmes këtij raporti të ju prezantoj aktivitetet e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM), të realizuara gjatë vitit 2010. Me këtë rast mund të konstatoj se gjatë vitit 2010, ZRRUM në mënyrë të suksesshme ka përballuar sfidat që ka pasur para veti dhe rrjedhimisht i ka përmbushur me sukses synimet e përcaktuara.

Në pjesën e dytë të vitit 2010, ZRRUM, ka filluar me implementimin e Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dhëna me rastin e aprovimit të Raportit Vjetor të Punës për vitin 2009, të datës 8 korrik 2010, dhe do të vazhdohet edhe në vitin 2011.

Gjatë vitit 2010, ZRRUM ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

- (i) **Përforcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme** me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe kredibilitetit të procesit rregullator;
- (ii) **Avancimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës** së kompanive të ujit dhe mbeturinave me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve;
- (iii) **Avancimi i procesit tarifor** me qëllim të ngritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave;
- (iv) **Bashkëpunimi me palët e interesit** me qëllim krijimit të një kornize ligjore dhe institucionale efektive që mundëson veprim të harmonizuar dhe inkluziv në krijimin e sektorëve të qëndrueshëm të ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Në planin institucional ZRRUM në vitin 2010, e ka avancuar më tutje çështjen e pavarësisë së vet operative dhe në veçanti të pavarësisë financiare në financimin e veprimtarisë së vet përmes taksave të cilat i paguajnë kompanitë e licencuara.. Po ashtu, në këtë plan ZRRUM ka vazhduar amandamentimin e legjislacionit sekondar si dhe kompletimin e politikave dhe procedurave të brendshme administrative. Dhe jo më pak rëndësi është edhe vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve të stafit në fusha të ndryshme si: avancimi i procesit tarifor, monitorimi i performancës, etj.

Në anën tjetër, duke qenë një prej aspekteve më të rëndësishme të punës së ZRRUM, avancimi i mëtutjeshëm i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës ka vazhduar të ketë një rëndësi të veçantë në aktivitetet e ZRRUM edhe në vitin 2010. Në këtë kuadër, ZRRUM ka publikuar dhe shpërndarë raportin vjetor të performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2010, në të cilin raport është dhënë një përmbledhje e zhvillimeve në sektorët e ujit dhe mbeturinave në Kosovë si dhe janë analizuar treguesit financiar, operativ dhe të nivelit të shërbimeve të 16 ndërmarrjeve publike që i rregullon ZRRUM.

Po ashtu, si edhe vitet e mëparshme ZRRUM ka shpallur dhe ka ndarë çmimet për kompanitë me performancë më të mirë, me qëllim të nxitjes së konkurrencës ndërmjet këtyre ndërmarrjeve.

Ka Zhvilluar takime të veçanta me Bordet dhe menaxhmentin e kompanive të ujësjellësit në të cilat është diskutuar performanca e tyre dhe janë nxjerrë rekomandimet për përmirësimin e treguesve të punës së tyre ka qenë një aktivitet me interes për të gjitha palët.

Në vitin 2010 sektori i shërbimeve të ujësjellësit ka shënuar progres në shumë tregues krahasues të performancës (TKP), krahasuar me vitin 2009. Sidomos evidente është progresi në Shkallën e

Arkëtimit ku është shënuar një përmirësim prej 3%, edhe pse jo me një përqindje të dëshiruar. Tani është me rëndësi që shumica e TKP-es, në 2010, kanë shënuar trende pozitive në krahasim me vitin 2009.

Performanca e Kompanive që shërbejnë në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në 2010, nuk është në nivel të kënaqshëm, dhe kompanitë nuk kanë qenë në gjendje t'i mbulojnë shpenzimet operative me të hyrat e inkasimit.

ZRRUM, avancimit të procesit tarifar, i ka kushtuar një pjesë të madhe të angazhimit të tij edhe në vitin 2010. Në këtë kontekst ZRRUM ka monitoruar sistematikisht efektet e tarifave të përcaktuara për periudhën 2009-2011, duke vlerësuar mos përmbushjen e objektivave të përcaktuara dhe në veçanti dinamikën e realizimit të investimeve kapitale. Në këtë plan ZRRUM ka konstatuar me keqardhje se caqet e përcaktuara nuk janë realizuar, sidomos dinamika e realizimit të investimeve të planifikuara. Ky mbetet një shqetësim serioz në ZRRUM për zhvillimet në sektor, të cilin e kemi shprehur në takimet tona të zhvilluara gjatë vitit 2010 me menaxhmentet e kompanive të ujit dhe të mbeturinave dhe me palët tjera të interesit.

Gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimin me të gjitha palët e interesit në Kosovë, në veçanti me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), pastaj me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me SHUKOS-in (Shoqatën e ndërmarrjeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit), Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), Ministrinë për Integritet Evropian (MIE), dhe donatorët.

Ka vazhduar bashkëpunimi me rregullatorët ekonomik të ujit të Shqipërisë, dhe Portugalisë, Ka pasur një takim të përbashkët në Shqipëri, si dhe shkëmbim të përvojave të stafit me Rregullatorin e Shqipërisë.

ZRRUM, edhe në vitin 2010 ka vazhduar të angazhohet me intensitet të shtuar në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Aktivitetet që ka ndërmarrë ZRRUM në këtë plan kanë ndikuar në vetëdijësimin më të madh konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe për krijimin nga ana e kompanive të një qasjeje më të fokusuar kah konsumatorët.

Që nga viti 2006, ZRRUM, nuk ka pasur auditim nga autoritetet audituese, prandaj për hir të korrektësisë, në shtator të vitit 2010, kemi parashtruar kërkesë Auditorit të Brendshëm të MEF, për kryerjen e auditimit, rreth kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit e shpenzimeve. Më 29 dhjetor kemi marrë Raportin Final të Auditimit të kryer, për vitin 2009. Menjëherë ka filluar implementimi i rekomandimeve të dhëna.

Në vitin 2010 ZRRUM ka përfituar një projekt 2 vjeçar "Mbështetje e mëtejshme për Forcimin Institucional të ZRRUM", i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, implementuar nga Konzerciumi i IPA, dhe shpresojmë se do të jetë një ndihmesë e madhe për avancimin e punës së institucionit tonë, në mbrojtjen e konsumatorëve, avancimin e sistemit të Monitorimit, Vlerësimit të Performancës, dhe **Avancimin e procesit tarifar**.

Raif Preteni
Drejtor i ZRRUM

2. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUM

2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM) është organ i pavarur rregullator, i cili bënë licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, Kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë, i themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK 2004/49](#) në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008 duke transferuar raportimin e ZRRUM, nga UNMIK-u tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUM është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- **Përcaktimi i tarifave** që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;
- **Dhënia e licencave** për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, grumbullimit të mbeturinave dhe deponimit të mbeturinave;
- **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve**, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit;
- **Monitorimi dhe raportimi i performancës** së ofruesve të shërbimeve;
- **Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shqyçje** individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;
- **Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve** dhe mbështetja e punës së tyre;
- **Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve të vjetra.**

Pra, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë, iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikente dhe cilësore me çmim të përballueshëm.

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086, si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekondar (14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të Amandamentuara kohë pas kohe, [edhe gjatë vitit 2010](#).

2.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM

Parimet me të cilat udhëhiqet ZRRUM në punën e vet, për të përmbushur misionin dhe synimet strategjike janë:

- **Pavarësia:** Ekzekutimi me profesionalizëm, por në mënyrë të pavarur i mandatit rregullator dhe përgjegjësiave ligjore në interes të qytetarëve të Kosovës;

- **Balancimi:** Përcaktimi i tarifave të balancuara të shërbimit, të cilat u mundësojnë kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave qëndrueshmëri financiare, me çka krijohen kushtet për ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante, por të cilat po ashtu marrin parasysh edhe mundësitë paguese të konsumatorëve.
- **Objektiviteti:** Monitorimi efektiv si dhe vlerësimi objektiv dhe transparent i punës së kompanive të licencuara, duke bërë krahasime të duhura në baza vjetore për performancën e tyre;
- **Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve:** Trajtimi i kontesteve dhe ankesave të konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë, duke involvuar edhe kompanitë e licencuara në këtë proces;
- **Konsultimi:** Konsultimi me palët e interesit për të siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e tyre, përmes shkëmbimit të informatave, memorandumeve të bashkëpunimit, mbajtjes së punëtorive të hapura, publikimit të raporteve relevante në ueb-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve.
- **Transparenca:** Publikimi i informatave në mënyrë të hapur dhe transparente për tu mundësuar të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUM-i;
- **Bashkëpunimi:** Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit dhe në veçanti me rregullatorët tjerë të sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë (siç janë MMPH dhe IKSHPK), për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë. Po ashtu, ky parim i referohet edhe bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në regjion dhe në Evropë, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira;
- **Mos-diskriminimi:** Sigurimi se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët, janë të drejta dhe nuk bëjnë diskriminim, apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve.

2.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori, si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës, si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore. Emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat 5 vjeçar.

Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit, sipas të cilës departamentet e ZRRUM i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.


ZRRUM për vitin 2010 ka propozuar domosdoshmërinë për rritjen e numrit të stafit, me qëllim të mbulimit sa më të mirë të përgjegjësiave të saj. Ky propozim është mbështetur me vendimin Nr. 03-V-356 të datës 8 korrik 2010 nga Kuvendi i Kosovës, me rastin e aprovimit të raportit vjetor të punës së ZRRUM-it për vitin 2009. Tri pozitat e hijezuara në organogram janë ende vakante dhe presim të plotësohen me rastin e miratimit të Buxhetit për vitin 2011.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet

përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullore, Departamenti i Performancës dhe Departamenti për Ligj dhe Licenca, ndërkohë përgjegjës për mbështetjen veprimtarisë rregullore të ZRRUM-it është Departamenti për Administratë dhe Financa.

Struktura organizative e ZRRUM është dhënë në Figurën 1 në vijim:

Figura 1: Organogram i ZRRUM



Tri vendet e hijezuara janë të paplotësuara, edhe pse Kuvendi i Kosovës në vitin 2010 parimisht e ka aprovuar dhe ka rekomanduar që MEF, me Buxhetin e vitit 2011, të ketë parasysh këto tri pozita.

2.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM

(i) Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it, në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Seksioni përfshijnë:

- zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit;
- zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit;
- udhëheqjen e procesit tarifar në frymën e dispozitave ligjore në fuqi;
- shqyrtimin dhe evoluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara;
- auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM-it.

(ii) Departamenti i Monitorimit të Performancës

Roli i Departamentit të Monitorimit të Performancës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara të ZRRUM-i, si dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky departament ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore, lidhur me performancën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Po ashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të Departamentit të Monitorimit të Performancës, përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shkyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

(iii) Departamenti për Ligj dhe Licencim

Departamenti për Ligj dhe Licencim i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it, në lidhje me aktivitetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrit, dhe gjykatave të Kosovës.

Departamenti për Ligj dhe Licencim është përgjegjës për hartimin dhe amandamentimin e legjislacionit sekondar, si dhe akteve tjera përcjellëse procedurale që kanë të bëjnë me kodifikimin e aktivitete të ZRRUM-it.

Ky Departament po ashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit, si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM.

(iv) Departamenti i Administratës dhe Financave të ZRRUM

Departamenti i Administratës dhe Financave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Departament ofron mbështetje administrative, gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikëqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Po ashtu ky Departament menaxhon prokurimin, procesin e buxhetit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin, administrimin e automjeteve, asetet e ZRRUM-it.

3. Aktivitetet Rregullatore të ZRRUM

3.1. LICENCIMI

Në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086 , ZRRUM, gjatë vitit raportues ka licencuar kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Për informimin e juaj më të plotë, po i paraqesim Kompanitë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompanitë për Furnizim të Ujit me Shumicë, Kompanitë e Licencuara për Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave, dhe Kompaninë e licencuar për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave.

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, ZRRUM ka licencuar kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit si vijon:

1. **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliqi, Podujevë, Lipjan, Shtime, dhe Drenas ;
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamush.;
3. **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe komuna e Deçanit¹;
4. **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRU “Hidrosistemi Radoniqi” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren;
6. **KRU “Hidromorava” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, dhe Viti;
7. **KRU “Bifurkacioni” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik².

¹ Komuna e Deçanit ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini”, derisa me një vendim të Kuvendit Komunal i Deçanit të vitit 2007 ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë regjionale “Hidrodrini” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim i KK Deçan konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK Deçan dhe kthimin e kësaj Kompanie nën autoritetin e KRU “Hidrodrini”.

² Komuna e Kaçanikut ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Bifurkacioni”, derisa me një vendim të Kuvendit Komunal të Kaçanikut të vitit 2009 po ashtu ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë rajonale “Bifurkacionit” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim (nr.1461/09) i KK Kaçanikut, konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUM.

Licencat e këtyre shtatë kompanive regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit janë në fuqi deri më 31 tetor 2012.

(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Furnizimi i ujit me shumicë me Rregulloren 2004/49 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

1. **“Ibër-Lepenci” Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.

Licenca e “Ibër –Lepencit” është valide deri më 31 tetor 2012.

(iii) Kompanitë e Licencuara për Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave

1. **KRM “Pastrimi” Sh.A.** që ofron shërbimet për komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Lipjan, Podujevë, dhe Graçanicë. ..
2. **KRM “Ekoregjioni” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Mamush dhe Sharr;
3. **KRM “Ambienti” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik, dhe Deçan³;
4. **KRM “Uniteti” Sh.A.** që ofron shërbimet e veta në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRM “Çabrat” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë;
6. **KRM “Higjiena” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Gjiilan, Kamenicë, Viti⁴, Novo Bërdo, Ranillug, Partesh dhe Kllokot;
7. **KRM “Pastërtia” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj, Shtime, Han i Elezit dhe Kaçanik.

Këtyre kompanive ju është vazhduar licenca më 01.12.2010, deri 30.11.2011.

iv) Kompania e licencuar për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave

1. Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë-KMDK, që menaxhon deponitë: në Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Prizren, dhe Stacionin e Transferit në Ferizaj.
Vlefshmëria e licencës 01.10.2007-30.09.2012

me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK kaqanikut dhe kthimin e kësaj Kompanie nën autoritetin e KRU “Bifurkacioni”.

³ Situata e njëjtë sikurse tek shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është edhe tek shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sa i përket komunës së Deqanit.

⁴ Kuvendi Komunal i Vitisë ka marrë poashtu vendim (në vitin 2008) që mos të jetë pjesë e KRM “Higjiena” dhe ka krijuar ndërmarrjen e veçante për shërbimet e mbeturinave, që poashtu bie ndesh me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.


(v) Kompanit e pa licencuara për menaxhimin me Deponit

1. KRM "Ambienti" 5Sh.A. menaxhon me Deponin Regjionale të Pejës,
2. KRM "Uniteti" 6Sh.A menaxhon me Deponin Regjionale të Mitrovicës,
3. KRM "Ekoregjioni" 7Sh.A menaxhohn me Deponin e Dragashit.

Në vijim, janë paraqitur zonat e shërbimit të kompanive regjionale të ujit (Figura 1) dhe të kompanive të mbeturinave (Figura 2).


⁵ **KRM "Ambienti"** ka qene e licencuar vetem nje here nga ZRRUM gjate perudhes 2007-2008aktualisht nuk eshte e licencuar per te menaxhuar me Deponin "Sverk"
Ngjajeshem eshte edhe me KRM "Uniteti për deponin ne 'Germova'
Deponia ne Dragash nuk ka qene asnjehere e licencuar nga ZRRUM.

Figura 1: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



KUR Prishtina	KUR Hidroregjioni Jugor	KUR Hidrodrini	KUR Mitrovica	KRU Radoniqi	KRUK Bifurkacioni	KRUK Hidromorava	Komunitat jashtë shërbimeve nga KUR-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Shtime	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Klina -Istogu -Juniku -Deqani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novoberda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca

Figura 2: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Grumbullimit të Mbeturinave



KRM Pastrimi	KRM Ekoregjioni	KRM Ambienti	KRM Uniteti	KRM Çabрати	KRM Pastërtia	KRM Higjiëna	Komunat jashtë shërbimeve nga KRM-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Graçanica	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi -Rahoveci -Mamusha	-Peja -Klina -Istogu -Deqani -Juniku	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova	-Ferizaj -Shtimja -Kaçaniku Hani i Elezit	-Gjilani -Kamenica -Vitia -Novoberda -Ranillugu -Klllokoti -Parteshi	-Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca

3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS

ZRRUM monitoron performancën e kompanive publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave. Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat i dorëzojnë këto ndërmarrje tek ZRRUM duke u bazuar në sistemin e raportimit të krijuar nga ZRRUM i quajtur OFCR/ROFK.

Përpos monitorimit, ZRRUM bën edhe vlerësimin e performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave, bazuar në Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) dhe raporton publikisht për performancën e tyre në formën e Raportit Vjetor të Performancës. Me qëllim të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga kompanitë e licencuara, ZRRUM bën auditimin e të dhënave dhe procedurave në bazë të të cilave gjenerohen të dhënat nga kompanitë. Procesi i auditimit kryhet gjatë periudhës janar-prill të vitit pasues, kështu që të dhënat e raportuara për performancën e kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2010 janë duke u audituar aktualisht. Megjithatë, në vazhdim është dhënë në formë të përmbledhur performanca operative, financiare dhe e shërbimeve ndaj konsumatorëve për kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave në bazë të licencës së lëshuar nga ZRRUM, sipas të dhënave të raportuara nga ato dhe të pa-audituar nga ZRRUM.

3.2.1 PERFORMANCA E SEKTORIT TË UJËSJELLËSIT DHE MBETURINAVE.

Në vazhdim të këtij raporti është dhënë një përshkrim i shkurtër i performancës së përgjithshme të sektorit të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, si dhe performanca individuale e kompanive publike, të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit- kanalizimit dhe shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, si dhe kompanisë e cila menaxhon me deponitë e Kosovës, dhe ka për qëllim të informimit të opinionit me performancën e vitit 2010, në krahasim me atë të vitit 2009.

Ky raport i performancës është bazuar në të dhënat e ofruara çdo muaj nga kompanitë, në pajtim me obligimet e tyre raportuese që kanë ndaj ZRRUM-it.

Të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport për vitin 2009, janë të audituara dhe si të tilla mund të konsiderohen të besueshme, çfarë nuk është rasti me të dhënat e vitit 2010 të cilat do të auditohen/verifikohen në muajin prill të këtij viti.

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të sektorit është bërë përmes 8 Treguesve Kyç të Performancës (TKP), të cilët përfshijnë aspektet operative, financiare dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Tabela 1. Performanca e përgjithshme e sektorit të shërbimeve të ujësjellësit

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	60%	58%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	3.7%	3.6%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	80%	79%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	66%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.05	0.97	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.09	0.11 ⁸	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.64	6.7	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	55.2	41.5	Trend negativ

Në vitin 2010 sektori i shërbimeve të ujësjellësit ka shënuar progres në shumë TKP, krahasuar me vitin 2009. Sidomos evidente është progresi në Shkallën e Arkëtimit ku është shënuar një përmirësim prej 3%, edhe pse jo me një përqindje të dëshiruar. Tani është me rëndësi që shumica TKP në 2010, kanë shënuar trendë pozitive në krahasim me vitin 2009.

1. Përderisa në Shkallën e Arkëtimit në vitin 2010 ka pasur një angazhim të theksuar nga institucionet përkatëse dhe donatorët por edhe nga vetë menaxhmenti i tyre, tek Uji i Pa faturuar (UPF), ende nuk kemi një angazhim të duhur nga menaxhmenti i kompanive në përmirësimin e këtij treguesi shumë të rëndësishëm i cili së bashku me Shkallën e Arkëtimit paraqesin dy treguesit të cilët më së shumti ndikojnë në qëndrueshmërinë e tyre. UPF në nivelin prej 60%, ende është shumë i lartë.
2. Kualiteti i ujit %, në vitin 2010 në nivel të sektorit ka shënuar trend negativ krahasuar me vitin 2009 për 0.1%, përderisa numri i mostrave të përgjithshme të analizuar për vitin 2010 në nivel të sektorit është 13,399, ndërsa për vitin 2009 ai ishte 13,138 d.m.th ka pas një rritje të numrit të mostrave të analizuar për 2%. Në vitin 2010 kemi pas 9,790 mostra bakteriologjike prej të cilave kanë dështuar 3.0% ndërsa mostra kimike 3,609 prej të cilave të dështuara janë 5.8%.

3.2.2 Performanca Individuale e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit

Në pjesën në vazhdim pasqyrohet performanca individuale e shtatë KRU në vitin 2010 në raport me vitin 2009, vlerësimi dhe krahasimi i performancës është bërë në këtë rastë përmes 9 (nëntë) TKP.

⁸ Trendet pozitive në treguesin e shpenzimeve operative për njësi (€/m³) në këtë raport janë për shkakun se në vitin 2010 janë marrë vetëm shpenzimet e shërbimeve të ujit përderisa për vitin 2009 në llogari janë përfshir edhe shpenzimet për shërbimet e kanalizimit dhe shpenzimet e përbashkëta (në 2009 ato janë raportuar të përbashkëta)

Tabela 2. Performanca e KRU 'PRISHTINA', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	55%	54%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	0.8%	2.0%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	81%	80%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	70%	65%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.19	1.06	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.10€	0.14€	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.65	5.75	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	65.64	32.0	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	19.0	-	

KRU 'Prishtina' sh.a., në vitin 2010 krahasuar me 2009 ka treguar Performancë më të mirë në shumicën prej treguesve kyç të performancës, përveç te uji i pa faturuar dhe tek ankesat e konsumatorëve ku trendët kanë qenë negative.

Gjatë vitit 2010 në raport me vitin 2009, shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 5%, dhe si rezultat i saj është shënuar edhe përmirësimi i normës së mbulimit të punës prej 1.19 që d.m.th se kompania ka qenë në gjendje t'i mbulojë të gjitha shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara dhe pjesën tjetër (19% nga totali i të hyrave) ta orientoj në projekte kapitale.

Kualitetit i ujit të furnizuar për konsumator nga KRU 'Prishtina' në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009, ka qenë më i mirë, me vetëm 0.8%, të mostrave të analizuar të cilat nuk kanë qenë në përputhje me standardet e përcaktuar nga IKSHPK.

Tabela 3. Performanca e KRU 'HIDROREGJIONI JUGOR', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	58%	55%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	9.0%	3.9%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	80%	79%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	69%	60%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.95	0.88	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.12€	0.12€	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.38	6.05	Trend negativ
Ankesat për '000 kons	15.0	25.0	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Gjatë vitit 2010 krahasuar me 2009, shkalla e arkëtimit edhe në KRU 'Hidroregjioni Jugor' është ngritur për 9%, dhe si rezultat i kësaj është ngritur edhe norma e mbulimit të punës. Megjithatë ajo ende është nën nivelin e mbulimit të shpenzimeve operative.

Te efikasiteti i stafit, kompania ka pas rënie (trend negativ) nga 6.05 sa ishte në vitin 2009 në 6.38 për vitin 2010 si rezultat i rritjes së numrit të stafit (për 14 punëtorë) për kundër rritje së numrit të konsumatorëve të regjistruar.

Kualiteti i ujit në vitin 2010, ka shënuar ngritje të dukshme prej 3.9% sa ishte në vitin 2009 në 9.0% për 2010, por dështimet më të mëdha si në aspektin kimikë ashtu edhe atë bakteriologjik, kanë qenë në njësinë operative të Prizrenit.

Tabela 4. Performanca e KRU 'HIDRODRINI', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	72%	74%	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	8.4%	8.3%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	85%	85%	Trend i njëjtë
Shkalla e arkëtimit %	59%	60%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.09	1.03	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.05€	0.05€	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.51	5.70	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	80.0	58.0	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

KRU 'Hidrodrini' edhe në vitin 2010 ka vazhduar me zvogëlimin e UPF edhe pse me një përqindje të vogël, është me rëndësi që trendi mbetet pozitiv, megjithatë niveli prej 72% mbetet ende shumë i lartë.

Norma e arkëtimit prej 60% edhe me tej është e përkeqësuar, ndonëse me një rënie të lehtë prej 1%.

Kualiteti i ujit në vitin 2010 ka trend negativ, duke rënë në 8.4% nga ajo 8.3% që ishte në vitin 2009. Në këtë normë të dështimeve të kualitetit të ujit ndikon njësia operative e Klinës, e cila i ka dështimet më të mëdha të mostrave edhe në aspektin kimik por edhe mikrobiologjik.

Tabela 5. Performanca e KRU 'MITROVICA', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	53%	51%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	2.4%	2.4%	Trend i njëjtë
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	56%	51%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	55%	51%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.65	0.67	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	0.10	0.10	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	10.26	10.27	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	1.2	-	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	20.0	18	Trend pozitiv

Në KRU 'Mitrovica' në 2010 në krahasim me 2009, është shënuar progres në Shkallën e arkëtimit dhe atë prej 4%. Por norma e mbulimit të punës ka pasur trend negativ dhe kjo për faktin se një pjesë të prodhimit të ujit e dërgon në pjesën veriore, të cilën nuk mundë ta faturoj dhe arkëtoj. Kjo kompani gjendet në pozitë të paqëndrueshme financiare me 65% të mbulimit të shpenzimeve operative nga mjetet e arkëtuar nga konsumatorët. Qeveria e Kosovës për këtë kompani edhe në vitin 2010, ka ndarë një ndihmë financiare në vlerë 384,053€, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve operative.

Po ashtu, numri i konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në vitin 2010, është ngritur për 5%, krahasuar me vitin 2009.

Kualiteti i Ujit të dërguar tek konsumatorët gjatë kësaj periudhe raportuese ka mbetur i njëjtë në nivel 2.4% të mostrave të dështuara.

Tabela 6. Performanca e KRU 'HS RADONIQI', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	65%	55%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	0.7%	0.7%	Trend i njëjtë
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	93%	94%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	67%	69%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.95	1.02	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	0.10€	0.12€	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	7.90	8.01	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	46.0	59.0	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Gjatë vitit 2010 krahasuar me 2009, uji i pa faturuar tek KRU 'Radoniqi', është ngritur për 10% kryesisht si rezultat i ngritjes së dukshme të ujit të prodhuar (për 16%), prej të cilës një pjesë nuk ka mundur të ju faturohet konsumatorëve.

Shkalla e arkëtimit ka rënë për 2%, gjatë vitit 2010 krahasuar me 2009 si pasojë e rritjes së faturimit dhe e zvogëlimit të të hyrave të arkëtuara kryesisht nga ana e konsumatorëve biznesor.

Norma e mbulimit të punës prej 1.02 sa ishte në vitin 2009 ka rënë në 0.95 në vitin 2010, e cila rënie tregon se kompania nuk ka qenë financiarisht në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në zvogëlimin e normës së mbulesës së punës prej viti në vit ka ndikuar zvogëlimi i të hyrave nga arkëtimi.

Te efikasiteti i stafit, kemi një ngritje (trend pozitiv) nga 8.01 në 7.90. Kjo ngritje është rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve të regjistruar, përkundër një rritjeje të lehtë të numrit të punëtorëve.

Kualiteti i ujit në vitin 2010 krahasuar me 2009 tek kjo kompani paraqet përqindjen më të ulët të mostrave të dështuar nga të gjitha kompanitë.

Tabela 7. Performanca e KRU 'BIFURKACIONI', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	60%	57%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	7.1%	10.3%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	68%	66%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	61%	61%	Trend i njëjtë
Norma e mbulimit të punës	1.19	1.24	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.09€	0.10€	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.19	6.59	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	10.0	33.0	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	20.0	19.45	Trend pozitiv

Në vitin 2010, KRU 'Bifurkacioni' në përgjithësi ka treguar Performancë më të mirë se shumica e treguesve në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2010 krahasuar me 2009 uji i pa faturuar (%) është ngritur kryesisht si rezultat i ngritjes së ujit të prodhuar, përkundër ngritjes së ujit të faturuar.

Në vitin 2010 krahasuar me 2009 shkalla e arkëtimit (%) nuk ka pësuar ndryshim.

Norma e mbulimit të punës prej 1.19 tregon se kompania në vitin 2010 ka qenë financiarisht e qëndrueshme dhe në gjendje të mirë, për t'i mbuluar shpenzimet operative me të hyrat e gatshme.

Edhe pse përqindja e kualitetit të ujit është ngritur nga 10.3% të testeve të dështuara sa ishte në vitin 2009 në 7.1% në vitin 2010, prapë se prapë kjo kompani mbetet në nivel jo të kënaqshëm me kualitetin e ujit të furnizuar.

Tabela 8. Performanca e KRU 'HIDROMORAVA', sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	60%	57%	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	1.3%	0.5%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	79%	78%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	68%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.12	0.90	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.08€	0.15€	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	8.30	8.90	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	150.0	122.0	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	-	-	S'ka Shënime

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRU 'Hidromorava', sh.a. në 5 (pesë) nga 9 (nëntë) tregues ka treguar performancë më të mirë .

Uji i pa faturuar në vitin 2010 krahasuar me 2009, është ngritur për 3%, si rezultat i rritjes së dukshme të prodhimit të ujit përkundër një ngritje shumë të vogël të faturimit të ujit.

Gjatë vitit 2010 krahasuar me 2009, shkalla e arkëtimit është ngritur për 5% dhe rezultat i kësaj është ngritja e të hyrave të arkëtuara, përkundër ngritjes së faturimit.

Norma e mbulimit të punës prej 1.12 tregon se kompania në vitin 2010 ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme. Në rritjen e këtij treguesi ka ndikuar rritja e të hyrave nga arkëtimi, si dhe zvogëlimi i shpenzimeve operative.

Efikasiteti i stafit është ngritur (trend pozitiv) si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve, përkundër një rënieje të lehtë të numrit të punëtorëve.

Përqindja e dështimeve të kualitetit të ujit në vitin 2010 ka shënuar ngritje në 1.3%, krahasuar me 2009 sa ishte 0.5%. Kjo ka ndodhë për shkak të disa dështimeve bakteriologjike në muajin Janar 2010, sidomos në njësinë operative në Gjilan

3.2.3 Performanca e Përgjithshme e Sektorit të Grumbullimit të Mbeturinave

Vlerësimi i performancës së sektorit të mbeturinave është bërë përmes 5(pesë) Treguesve Kyç të Performancës (TKP).

Tabela 9. Performanca relative e KRM-ve

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	57%	55%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.89	0.87	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	34.29	32.32	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	9.38	9.26	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	11.16	5.96	Trend negativ

Performanca e Kompanive që shërbejnë në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në 2010, nuk është në nivel të kënaqshëm edhe pse në dy tregues financiar trendët kanë qenë pozitive, sidomos në shkallën e arkëtimit në nivel të sektorit ajo është ngritur për 2%, duke ndikuar që edhe e norma e mbulimit të punës të ketë ngritje nga 0.87 sa ishte në vitin 2009 në 0.89 në vitin 2010. Me gjithë këtë kompanitë nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojnë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme.

Shpenzimet operative për ton mbeturina të grumbulluar, në nivel të sektorit janë ngritur nga 32.32€ në 34.29€.

3.2.4 Performanca Individuale e Kompanive Rajonale të Mbeturinave

Në vijim është paraqitur një pasqyrë e trendëve të zhvillimit për secilën kompani, në disa prej treguesve Kyç të Performancës.

Tabela 10. Performanca e KRM 'PASTRIMI' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	54%	51%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.97	0.92	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	35.01	31.87	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	8.96	9.04	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	23.28	10.52	Trend negativ

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRM 'Pastrimi' sh.a., ka treguar performancën më të mirë të shumica e treguesve kyç, përveç shpenzimeve për njësi dhe ankesat për 1000 konsumatorë ku trendët kanë qenë negative.

Shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 3%. Kjo ngritje është si shkak i ngritjes së të hyrave nga arkëtimi, përkundër një ngritjeje të lehtë të faturimit, edhe pse norma e mbulimit të punës ka pas një ngritje nga 0.92 sa ishte në vitin 2009, në 0.97 për vitin 2010, prapë së prapë kjo kompani nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme. Në ngritjen e normës së mbulimit të punës ka ndikuar rritja e të hyrave nga arkëtimi, përkundër rritjes së shpenzimeve operative. Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 31.87€ në 35.01€ si shkak i rritjes së shpenzimeve të pagave dhe të shpenzimeve të tjera, dhe i zvogëlimit të mbeturinave të grumbulluara prej 4,885 ton.

Tabela 11. Performanca e KRM 'ECO-REGJIONI' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	56%	63%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.85	0.84	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	32.64	37.34	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	9.18	9.08	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	5.64	7.08	Trend pozitiv

Në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009, KRM 'Eco-regjioni' sh.a., ka treguar performancën më të dobët në treguesit shkalla e arkëtimit dhe efikasiteti i stafit, ndërsa në treguesit tjerë performanca ka qenë pozitive.

Në Shkallën e arkëtimit kjo kompani ka treguar efikasitet më të dobët në vitin 2010 në raport me atë 2009, me ç'rast norma e arkëtimit ka rënë për 7%.

Edhe pse norma e mbulimit të punës ka pas një ngritje të vogël nga 0.84 sa ishte në vitin 2009 në 0.85 për vitin 2010, prapë se prapë kjo kompani nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme. Në ngritjen e këtij treguesi prej 1% ka ndikuar ngritja e të hyrave tjera operative, përkundër rritjes së shpenzimeve operative.

Në vitin 2010 krahasuar me 2009 shpenzimet operative për ton kanë shënuar një rënie për 4.70€, si rezultat i rritjes së grumbullimit të mbeturinave, përkundër ngritjeve në disa nga kategoritë e shpenzimeve,

Tabela 12. Performanca e KRM 'AMBIENTI' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	54%	53%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.81	0.95	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	29.90	31.18	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	6.96	7.05	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	1.08	0.78	Trend negativ

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRM 'Ambienti' sh.a., ka treguar performancë më të mirë në 3(tre) nga 5(pesë) treguesit kyç të performancës, përveç në normën e mbulimit të punës dhe ankesat për 1000 konsumator, ku trendët kanë qenë negative.

Gjatë vitit 2010 shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 1%. por norma e mbulimit të punës prej 0.81 tregon se kompania nuk ka qenë financiarisht në gjendje t'i mbulojë te gjitha shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara.

Shpenzimet operative për ton kanë shënuar një rënie të lehtë prej 31.18 në 29.90 e cila vjen si rezultat i rritjes së mbeturinave të grumbulluara, edhe përkundër rritjes së shpenzimeve tjera operative.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar te efikasiteti i stafit.

Tabela 13. Performanca e KRM 'UNITETI' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	59%	56%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.67	0.73	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	24.95	22.73	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	17.39	15.52	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	8.28	2.59	Trend negativ

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRM 'Uniteti' sh.a., ka treguar performancë më të dobët në shumicën e treguesve kyç të performancës.

Gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009 shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 3%. Në vitin 2010 norma e mbulimit të punës prej 0.67 tregon se vetëm 67% e shpenzimeve kanë mundur të mbulohen nga të hyrat e gatshme. Rënia e normës prej 6% ka të bëjë me zvogëlimin në total të të hyrave tjera operative dhe me ngritjen e shpenzimeve operative.

Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 22.73€ në 24.95€ dhe kjo ka ndodh si shkak i rritjes shumë të lartë të shpenzimeve në kategoritë, riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, si dhe derivateve dhe zvogëlimi i mbeturinave të grumbulluara.

Edhe te efikasiteti i stafit kemi një rënie nga 15.52 në 17.39, dhe kjo rënie është shkak i rritjes së numrit të punëtorëve dhe i zvogëlimit të numrit të konsumatorëve.

Tabela 14. Performanca e KRM 'ÇABRATI' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	59%	50%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.92	0.82	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	35.32	29.80	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	10.65	10.68	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	6.96	8.91	Trend pozitiv

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRM 'Çabрати', ka treguar performancë më të mirë të shumica e treguesve kyç, përveç te kostoja për njësi ku trendi ka qenë negativ.

Shkalla e arkëtimit gjatë kësaj periudhe raportuese është ngritur për 9%. Me normë të mbulimit prej 0.92 për vitin 2010, kjo kompani nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet e saja operative. Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 29.80€ në 35.32€ gjatë kësaj periudhe raportuese si rezultat i rritjes po thuajse të të gjitha kategorive të shpenzimeve operative e sidomos pagesa e taksës së deponimit të mbeturinave.

Tabela 15. Performanca e KRM 'PASTËRTIA' sh.a

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	61%	51%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.90	0.87	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	46.55	40.67	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	8.70	8.50	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	6.12	0.00	Trend negativ

Kjo kompani gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009 në shkallën e arkëtimit ka shënuar ngritje për 10%.

Norma e mbulimit të punës prej 0.90 tregon së kompania, në vitin 2010, edhe përkundër rritje se shkallës së arkëtimit ende nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme.

Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 40.67€ në 46.55€ dhe kjo ka ndodh si rezultat i rritjes pothuajse të të gjitha kategorive të shpenzimeve operative, dhe i zvogëlimit të mbeturinave të grumbulluara.

Të efikasiteti i stafit kemi një rënie (trend negativ) nga 8.50 në 8.70, e cila është rezultat i rritjes së numrit të punëtorëve, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Tabela 16. Performanca e KRM 'HIGJIENA' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	66%	62 %	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.90	0.86	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	46.17	35.39	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	8.57	8.62	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	6.12	4.40	Trend negativ

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, KRM 'Higjiena' sh.a., ka treguar trend pozitiv në shkallën e arkëtimit dhe në normën e mbulimit të punës, por në 3(tre) treguesit e tjerë trendët kanë qenë negativ.

Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 35.39€ në 46.17€ dhe kjo ka ndodh si shkak i rritjes së shpenzimeve operative kryesisht në kategoritë e pagave, derivateve si dhe riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, por edhe i zvogëlimit të mbeturinave të grumbulluara prej 2,452 ton.

Edhe te efikasiteti i stafit kemi rënie (trend negativ) nga 8.62 në 8.57.

3.2.5 Performanca e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave në Kosovë (KMDK)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur trendët e zhvillimit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.

Tabela 17. Performanca relative e 'KMDK' sh.a.

Treguesit	2010	2009	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	58%	45%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.90	0.82	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	3.37	2.94	Trend negativ

Në vitin 2010 krahasuar me 2009, 'KMDK' sh.a, ka treguar performancë më të mirë në treguesit të shkalla e arkëtimit dhe normën e mbulimit të punës.

Gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009, shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 13%. Kjo ngritje është rezultat i ngritjes së efikasitetit të arkëtimit nga ana e menaxhmenti të saj.

Në vitin 2010 krahasuar me 2009 edhe përkundër ngritjes së normës së mbulimit të punës prej 0.82 në 0.90, kjo kompani ende nuk është në gjendje të qëndrueshme financiare për të mbuluar shpenzimet operative me të hyrat e mbledhura nga faturimi.

3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT

Objektivi kryesor i ZRRUM, gjatë vitit 2010, ishte ngritja e ndikimit të tij për aspektet e proceseve rregullative të përcaktimit të tarifave të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për kompanitë e licencuara, duke respektuar të gjitha atributet e legjislacionit që i rregullojnë këto dy sektorë të rëndësishme të shërbimeve publike.

3.3.1. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave

Mbi bazën e rregullimit të shërbimit të mbeturinave, në punën tonë vjetore për këtë shërbim, ZRRUM ka vazhduar caktimin e tarifave vjetore për këtë sektor, të cilat aplikohen gjatë periudhës së ardhshme një (1) vjeçare për kompanitë të cilat merren me; (i) grumbullimin e mbeturinave të ngurta të bashkësive familjare, (ii) bizneseve dhe industrisë, (iii) dhe ato të institucioneve.

Afati i vlefshmërisë së tarifave të këtij shërbimi ndërlidhen me periudhën kohore: 1 qershor 2010 – 31 maj 2011, të cilave u kanë paraprirë përgatitjet paraprake të cilat ndërlidhen me fillimin e muajt shkurt të vitit të kaluar.

Parimet e përcaktimit të tarifave një (1) vjeçare janë mbështet s'paku në pesë (5) kategori dhe praktika të njohura ekonomike, të cilat i kemi pas si pik nisje, nga të cilat po përmendim:

- mbulimin e plotë të kostove operative të ofruesit të shërbimeve, edhe pse të njëjtat nga aspekti ekonomik në fillim mund të ishin të diskutueshme,
- marrjen në konsideratë të mbulimit të një shume të caktuar të kostove të investimeve kapitale me tarifë,
- njohjen si kosto të një shume të caktuar të llogarive të arkëtueshme, të pa mbledhshme, të cilat supozohet se nuk mund të inkasohen në rrethanat aktuale të shoqërisë sonë,

- gjykimin e autoritetit tonë për balancim të tarifave për të mundësuar grupime më të mëdha të konsumatorëve, për ti paguar faturat për shërbimet që i marrin,
- tarifat janë përcaktuar në bazë të kostove të çdo regjioni veç e veç dhe kanë vlerë si të tilla për të gjithë regjionin – pa bërë diskriminim të konsumatorëve të shërbyer etj.

(I) Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave

Disa informata shtesë nga metodologjia e përcaktimit të tarifave të këtij shërbimi të cilat kanë qenë të aplikuara më parë dhe të cilat janë implementuar edhe gjatë procesit të fundit, mund të jetë me interes për ti përmend për palët që se kanë të qartë gjithë aktivitetin rreth kësaj pune;

- tarifat për shërbimet e bashkësive familjare kanë qenë dhe janë unike në regjion,
- tarifat komerciale-industriale kanë qenë dhe janë të diferencuara, varësisht se për cilat grupime të konsumatorëve të njëjtat ofrohen dhe në raste të caktuara se ku janë të lokalizuara të njëjtat, dhe
- tarifat institucionale të cilat po ashtu janë të diferencuara sipas praktikës së tarifave të grupimit të konsumatorëve komercial –industrial.

Tarifat e procesit rregullatorë për këtë sektor gjatë vitit 2010-2011 janë përmbyll gjatë muajt qershor 2010 dhe ndonjë sqarim ka mbet edhe gjatë fillimit të muajt gusht dhe të njëjtat janë të zbatueshme gjer me 31 maj 2011.

Do të ishte e pa përshtatshme pasqyrimi i tyre në këtë raport, pasi që bëhet fjalë për tetë (8) kompani regjionale për administrim me mbeturina për shkak specifikave të tyre të veçanta.

3.3.2. Të dhënat për tarifat e sektorit të mbeturinave

Në tabelën e më poshtme po i ofrojmë të dhënat e tarifave të përcaktuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë dhe atë të KMDK-ës, për proceset e rregullta rregullatorë të viteve 2009-2010 dhe ato të vitit 2010 – 2011.

Vlefshmëria e tarifave ekzistuese është në kolonën e katërt (4) për periudhën: **1 qershor 2010 – 31 maj 2011.**

Duhet theksuar se tarifat e dhëna më poshtë janë të llogaritura pa TVSH.

Tabela 18. Për shërbimet e administrimit të mbeturinave

Numri rendor	Emërtimi i kompanive	Tarifa e shërbimit 06-2009/05-2010 €/muaj	Tarifa e shërbimit 06-2010/05-2011 €/muaj	% e tarifës së ngritur nga një vit te tjetri
1	KRM "Çabrat" Sh. a. Gjakovë	4,22	4,31	2,13
2	KRM "Pastrimi" Sh. a. Prishtinë	4,14	4,14	0,00
3	KRM "Pastërtia" Sh. a. Ferizaj	4,01	4,01	0,00
4	KRM "Higjiena" Sh. a. Gjilan	3,74	3,93	5,08
5	KRM "Eko-Regjioni" Sh. a. Prizren	3,65	3,88	6,30
6	KRM "Ambienti" Sh. a. Pejë	3,45	3,45	0,00
7	KRM "Uniteti" Sh. A. Mitrovicë	3,45	3,45	0,00
	Mesatarja e tarifave për konsumatorët shtëpiakë prej 1-7	3,81	3,88	1,93
8	KMDK Sh. a. Prishtinë	5,26 €/ton	5,26 €/ton	0,00

Për shkak të hapësirës dhe ndërlikueshmërisë së prezantimit, ZRRUM nuk i pasqyron tarifat e dy grupimeve të tjera të konsumatorëve, por, nëse ekziston ndonjë interesim për të njëjtat, jemi të gatshëm të ofrojmë të dhëna sqaruese kurdo që kërkohet nga ZRRUM.

3.3.3. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit

Për shtatë (7) kompanitë regionale të licencuara që ofrojnë shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, janë përcaktuar tarifat tre vjeçare për herë të parë dhe një tarifë një (1) vjeçare për furnizim me ujë me shumicë të një regionin të plotë të caktuar dhe pjesërisht edhe për të dytin, e cila ka mbetë e pa ndryshuar edhe ajo që tri vite.

Duhet theksuar se tarifa e ujit të furnizuar me shumicë nga NH "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë gjatë vitit 2009 ka mbetë e tillë edhe gjatë vitit 2010 dhe tani për vitin 2011, duke marrë parasysh kërkesën e vet ndërmarrjes të argumentuar me vështirësitë që e njëjta ka me inkasimin e faturave nga KRU "Mitrovica" sh. A. Mitrovicë, me arsyetimin e tyre se kanë dashur për ta ndihmuar të njëjtën në një formë apo tjetrën dhe duke prit që ti hyhet procesit të ardhshëm rregullatorë, kur priten të përcaktohen tarifat tre vjeçare 2012-2014. Duke u nisur nga karakteri i pronësisë së tyre një kërkesë e tillë është kuptuar si e arsyeshme edhe për ZRRUM-in.

3.3.4. Të dhënat për shpenzimeve operative

Nga aspekti sektorial kompanitë të tri grupime të shpenzimeve, kanë shpenzuar ma pak se sa u ishte lejuar edhe pse nga disa aspekte kjo mund të interpretohet në forma dhe mënyra të ndryshme dhe që të gjitha përveç Radoniqit kanë tejkaluar shumën e shpenzimeve të lejuara për shpenzime të energjisë elektrike,

Tabela Nr. 19. Të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative

Të dhënat e shpenzimeve financiare	Njësia	UJË					KANALIZIM				
		Historik e 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	%	Vlerë s. Përfun. 2010	Historik e 2009	Aprovuar 2010	Realizuar. 2010	%	Vlerësi mi Përfundimtar, 2010
Stafi (personeli)	€	5,192,260	5,406,600	5,352,352	-1	Pozitiv	366,605	699,150	536,114	-23%	Pozitiv
Energjia elektrike	€	2,405,629	1,870,500	2,694,725	+44	Negativ	52,571	93,225	54,533	-42%	Pozitiv
Shpenzimet tjera operative	€	3,370,787	3,631,800	2,297,215	-37	Pozitiv	73,040	436,800	129,671	-70%	Pozitiv
Σ e shpenzimeve operative	€	10,968,676	10,908,900	10,344,292	-5	Pozitiv	492,215	1,229,175	720,318	-41%	Pozitiv

Tabela. Nr. 20. Të dhënat e mbulueshmërisë së shpenzimeve të përgjithshme operative të ndodhura gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2010. Në këtë tabelë ka hy edhe shuma e investimeve vetanake të realizuara

N R	KRU	Arkëtimi €	Shpenzimet Operative €	Mbetja Financiare €	Investimet Kapitale vetanake €	Shkalla e mbulueshmërisë financiare
	A	B	C	D	E	F=B/(C+E)
1	Prishtina	5,252,576	4,523,870	728,706	330,348	1.08
2	Mitrovica	794,223	1,367,497	-573,274	28,284	0.57
3	Hidrodrini	1,081,828	1,165,077	-83,249	132,295	0.83
4	Radoniqi	1,301,320	1,432,280	-130,960	14,808	0.90
5	Prizreni	1,323,532	1,429,870	-106,338	203,004	0.81
6	Bifurkacioni	464,990	446,449	18,541	23,982	0.99
7	Hidromorava	643,413	699,567	-56,154	22,500	0.89
	Të dhënat sektoriale	10,861,882	11,064,610	-202,728	755,221	0.92

3.3.5. Të dhënat për investimet kapitale vetanake dhe nga donatorët

Për sa i përket shumave të investimeve kapitale të aprovuara për realizim gjatë vitit 2009 nga mjetet financiare vetanake të lejuara për vitin 2009 prej 4,397,531 €, janë realizuar vetëm 991,099€.

Ndërsa ato të planifikuara për financim nga donatorët potencial ishin paraparë të arrinin shumën prej rreth 35 milion €, e janë realizuar vetëm 2,231,542 €.

Ndërsa për grupimin e këtyre të dhënave të financuar nga mjetet financiare vetanake për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2010, kompanive u është lejuar shuma e investimeve prej 7.2 milion € dhe për periudhën e shikuar të njëjtat janë realizuar mbi 754,746 €, që është vetëm rreth 10.00% të shumës së planifikuar.

Tabela Nr. 21. Shuma e investimeve vetanake të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara prej ZRRUM për vitin 2010, si dhe të realizuara nga KRU-të gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2010 €

INVESTIMET VETANKAE						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë 9 mujorit të 2010	% 9-mujore e investimeve të realizuara	Vlerësimi përfundimtar 9 mujor
1	Prishtina	3,027,500	2,926,934	330,348	11.29%	Negativ
2	Mitrovica	642,200	444,461	28,284	6.36%	Negativ
3	Hidrodrini	1,242,200	687,137	132,295	19.25%	Negativ
4	Radoniqi	811,325	1,142,693	14,350	1.26%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	692,800	712,997	203,004	28.47%	Negativ
6	Bifurkacioni	985,000	933,177	23,982	2.57%	Negativ
7	Hidromorava	375,950	395,865	22,500	5.68%	Negativ
	Totali	7,776,975	7,243,264	754,764	10.42%	Negativ

Tabela Nr. 22. Shuma e investimeve nga donacionet të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara prej ZRRUM për vitin 2010, si dhe të realizuara nga KRU-t gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2010 (€)

INVESTIMET NGA DONACIONET						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë 9 mujorit të 2010	% 9-mujore e investimeve të realizuara.	Vlerësimi përfundimtar 9-mujor
1	Prishtina	27,773,340	27,773,340	194,616	0.70%	Negativ
2	Mitrovica	515,300	515,300	570,825	110.78%	Pozitiv
3	Hidrodrini	280,000	280,000	1,026,225	366.51%	Pozitiv
4	Radoniqi	2,550,000	2,550,000	139,327	5.46%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	11,773,006	11,773,006	769,472	6.54%	Negativ
6	Bifurkacioni	425,000	425,000	147,519	300.96%	Pozitiv
7	Hidromorava	100,000	100,000	87,000	87.00%	Pozitiv
	Totali	43,416,646	43,416,646	4,066,562	9.37%	Negativ

3.3.6. Pasqyra e tarifave të përcaktuara tre vjeçare 2009-2011

Për ta rrumbullakuar gjithë atë që theksuam ma lartë në vijmë po i pasqyrojmë edhe të dhënat për tarifat të kompletuar nga procesi rregullatorë 2009 – 2011, për të krijuar një përshtypje të

plotë të tyre dhe dëshmuar se tarifat volumetrike kanë pas ngritje të shkallëzuar dhe të ekuilibruar gjatë tri viteve, për tu përballuar ma lehtë nga konsumatorët dhe për të qenë mjaft stimuluese për kompanitë.

Tabela 23: Tarifat e aprovuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit: 2009-2011

Kompania Regjionale	Kategoria e tarifave	Njësia	Tarifa për Kons. Shtëpiak			Tarifa për Kons. Jo-shtëpiak		
			2009	2010	2011	2009	2010	2011
KUR 'PRISHTINA' Prishtinë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.30	0.32	0.34	0.72	0.76	0.81
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.03	0.04	0.04	0.07	0.09	0.10
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.36	0.38	0.79	0.85	0.91
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.22	0.24	0.27	0.46	0.51	0.57
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.04	0.04	0.04	0.05	0.08	0.08
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.26	0.28	0.31	0.54	0.59	0.65
KUR 'HIDRODRINI' Pejë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.17	0.18	0.19	0.41	0.42	0.43
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.07	0.08	0.09
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.22	0.23	0.24	0.48	0.50	0.52
KUR 'RADONIQI' Gjakovë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.27	0.28	0.29	0.57	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.11	0.11	0.11
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.32	0.33	0.34	0.68	0.73	0.75
KUR 'MITROVICA' Mitrovicë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.25	0.27	0.28	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.09	0.10	0.11	0.14	0.15	0.18
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.34	0.37	0.39	0.74	0.77	0.82
KUR 'HIDROMORAVA' Gjilan	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.30	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.07	0.07	0.07	0.10	0.11	0.12
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.35	0.36	0.37	0.70	0.73	0.76
KUR 'BIFURKACIONI' Ferizaj	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.29	0.70	0.72	0.73
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.06	0.13	0.13	0.15
	Volumi-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.34	0.35	0.83	0.85	0.88

Konkluzionet e nxjerra nga ky raport pune për periudhën e shikuar

Duke pas parasysh përvojën e kaluar gjatë vitit 2010, por edhe ato të më parme, mund të konkludohet se nga aspekti i qëndrueshmërisë financiare të gjitha kompanive u janë krijuar mundësitë (te të dy shërbimet e këtij sektorit), të arrijnë nivel të mirë të funksionalitetit të tyre dhe efikasitetit relativisht të mirë e cila mbështetet në këto parakushte të krijuara nga aspekti rregullator;

është marrë parasysh qëndrueshmëria financiare nga aspekti i mbulimit të kostove operative dhe një shume të caktuar për investime kapitale,

kjo mbështetet me faktin se tarifat kanë qenë të përcaktuara mbi kriteret dhe metodologjitë dhe politikat e mira ekonomike për kohën nëpër të cilën po kalojmë edhe pse jo të njëjta për të dy sektorët,

shkalla e mos-realizuar e inkasimit sipas proceseve të përcaktuara rregullatore ka ndikuar që objektivat mos të përmbushen dhe me të cilat janë njoftuar palët e interesit,

tarifat kanë qenë të projektuara mirë dhe të balancuara nga aspekti i qëndrueshmërisë ekonomike, të cilat kanë qenë stimuluese për një punë të mirë dhe efikase, po të ishin arritur objektivat e përcaktuara,

lartësia e tarifave është në nivelin e mesatareve të regjionit dhe në krahasim me to dhe në disa raste edhe më të ulëta se të njëjtat etj.

3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

3.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Me qëllim të përmirësimit të standardeve të shërbimeve ndaj konsumatorëve, nga ana e ZRRUM-it janë ndërmarrë aktivitete të gjithanshme si:

- organizimi i punëtorive dhe debateve me kompanitë dhe palët e tjera të interesit ku janë diskutuar dhe janë bartë përvojat më të mira ndërmjet kompanive,
- dhënia e rekomandimeve për kompanitë e ujit dhe kërkimi i zotimeve specifike nga to, për përmbushjen dhe përmirësim të ndjeshëm të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, në pothuajse të gjitha kompanitë e ujit, janë themeluar zyra për relacione me konsumatorë. Këto zyra janë pajisur me personel dhe infrastrukturë të nevojshme për trajtimin efikas të ankesave të konsumatorëve.

Po ashtu, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), ZRRUM në vazhdimësi ka përcjell cilësinë e ujit të pijes dhe me kohë ka reaguar kur ka pasur dështime të cilësisë së ujit.

3.4.2. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve përmes KKK-ve

ZRRUM si rregullator i pavarur ekonomik i sektorit të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, në fokus të aktiviteteve të saja, ka mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke siguruar që kompanitë e ujit dhe të mbeturinave nuk e keqpërdorin pozitën e tyre monopole dhe që të ju ofrojnë konsumatorëve të tyre shërbime kualitative dhe efikase, me çmim sa më të volitshëm.

Për këtë qëllim ZRRUM ka krijuar dhe mbështetur mekanizma të fuqishëm për zgjedhjen e kërkesave dhe ankesave të tyre. Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të saja ligjore, që dalin nga Rregullorja 2004/49, përkatësisht Ligjit (Nr. 03/L-86) për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave në Kosovë, në bashkëpunim të plotë me Komunitetet përkatëse, në shtatë regjionet e Kosovës i ka themeluar Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe funksionimin e këtyre Komisioneve.

KKK, kanë rol të dyfishtë. Ato i përfaqësojnë dhe këshillojnë konsumatorët dhe gjithashtu kanë detyrë të shqyrtojnë dhe zgjedhin ankesat e tyre, kur ata nuk janë të kënaqur, apo mendojnë se ankesa apo kërkesa e tyre nuk është zgjedhur në mënyrë të drejtë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Edhe gjatë vitit 2010, ZRRUM i ka ofruar mbështetje të gjithanshme materiale, logjistike dhe organizative, për të gjitha KKK.

Gjithashtu janë evidente disa suksese të rëndësishme në punën e tyre që konsistojnë:

- Në KKK janë të përfaqësuar të gjitha komunitetet të cilat i janë nënshtruar procesit të konsolidimit dhe të rajonalizimit, përfshi edhe komunitetet të cilat me vendime të njëanshme janë larguar nga Kompanitë Rajonale.
- Janë mbajtur takime të rregullta në baza mujore ku janë shqyrtuar dhe zgjedhur një numër i konsiderueshëm i ankesave dhe kërkesave në mes të Konsumatorëve dhe KRU, si dhe janë shqyrtuar dhe janë dhënë rekomandime për shumë çështje rregullatore,
- Numri i ankesave të parashtruara dhe të zgjidhura në KKK, ka pasur rritje nga viti në vit dhe në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009, kemi një rritje prej 100% ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara, dhe kjo është si rezultat i një aktiviteti të shtuar të KKK,
- Vendosija e bashkëpunimit të ngushtë dhe korrekt me Ofruesit e Shërbimeve, Shoqatat, Institucionet, si dhe projektet e ndryshme të cilat kanë në fokus konsumatorin e sidomos me projektin 'Mbështetja e Mëtejshme Institucionale për ZRRUM', i cili financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE), dhe me projektet e tjera siç është rasti me projektin e K-WISER, i mbështetur financiarisht nga USAID-i, e të cilët janë duke dhënë një kontribut të çmueshëm në sektorin e shërbimeve të ujit në përgjithësi,
- Informimi më i mirë i Konsumatorëve për rolin dhe funksionet e KKK-ve dhe sensibilizimin e opinionit publik për rolin e KKK-ve. Në këtë drejtim, ZRRUM ka përgatitur dhe shpërndarë Kompanive më se 100.000 broshura në 2 gjuhë, si dhe janë bërë njoftime publike përmes gazetave ditore për orarin e takimeve mujore të KKK.

Në vijim është dhënë në formë tabelore, numri dhe struktura e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të regjionale në vitin 2010.

Tabela 24. Numri i Ankesave të Parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	3	7	8	3	7	2	2	2	8	2	1	-	45
KKK Mitrovicë													
KKK Pejë			1										1
KKK Gjakovë	3			1	1		2						7
KKK Prizren									1				1
KKK Ferizaj							1				1		2
KKK Gjilan													
Gjithsejtë	6	7	9	4	8	2	5	2	9	2	2	-	56

Tabela 25. Numri i Ankesave të Zgjedhura nga KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë			1	1	1	1	1	1					6
KKK Mitrovicë													
KKK Pejë													
KKK Gjakovë	1				1								2
KKK Prizren									1				1
KKK Ferizaj							1					1	2
KKK Gjilan													
Gjithsejtë	1		1	1	2	1	2	1	1			1	11

Nga tabelat shihet se KKK-të të regjionit të Prishtinës, i kanë arritur më shumë ankesa të cilat kanë të bëjnë me KRU 'Prishtina', duke u pasuar nga KKK i Gjakovës, i cili ka pranuar 7 ankesa. Nga tërë numri prej 56 ankesave vetëm 11 prej tyre janë zgjedhur, përdërisa 5 prej tyre janë kthyer për plotësim lënde dhe 36 i janë kthyer KRU 'Prishtinës' për ti zgjidhur.

Natyrë e ankesave kryesisht është për shkak të Faturimit Paushall, Zbritja/Shlyerja e Borxhit por edhe për shkak se tarifat janë të larta. Numri më i madh i ankesave 52 kanë arritur nga Konsumatorët Shtëpiakë, përdërisa vetëm 4 janë nga kategoria e konsumatorëve jo shtëpiak.

4. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV

(i) Amandamenti i Legjislacionit Primar

Me aprovimin e Ligji Nr. 03/L-086, përgjegjësia e ZRRUM është transferuar nga UNMIK/PSSP tek Kuvendi i Kosovës.

Themelimi dhe funksionimi i ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator bazohet në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërkaq bazën ligjore për veprimtarinë e ZRRUM si rregullator ekonomik i ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave sipas Ligjit Nr. 03/L-086.

Meqenëse Ligji Nr. 03/L-086 nuk e ka ndryshuar përmbajtjen e Rregullores 2004/49, përpos që ka transferuar përgjegjësitë nga UNMIK-u te Kuvendi i Kosovës, ZRRUM, në vitin 2009, ka iniciuar dhe është angazhuar për amandamentimin e këtij ligji. Kjo iniciativë është filluar me qëllim të harmonizimit të këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi dhe me qëllim të definimit më të mirë të disa aspekteve të cilat janë evidentuar si problematike gjatë këtyre viteve të zbatimit të tij. Konkretisht, arsyet për amandamentimin e Ligjit Nr. 03/L-086 respektivisht Rregullores 2004/49, janë:

- Ndryshimin e emërimit të Rregullatorit në pajtim me emërtimet e agjensioneve sipas Kushtetutës dhe rregullatorëve tjerë si motra,
- Autorizimi legjislativ i nxjerrjes së akteve administrative,
- Përcaktimi më i qartë i obligimeve raportuese të ZRRUM ndaj Kuvendit të Kosovës në njërin anë, dhe i obligimeve raportuese të ofruesve të shërbimeve ndaj ZRRUM në anën tjetër
- Definimi më i saktë i statusit financiar të ZRRUM si autoritet që financohet nga taksat e licencimit të cilat i paguajnë ndërmarrjet publike të licencuara
- Rishikimi i disa dispozitave që kanë të bëjnë me tarifat dhe me rregullimin e borxheve të vjetra

Me që ky aktivitet nuk ka arriti të përfundoj në 2010, është në vazhdimësi edhe për vitin 2011.

Ky ligj nuk është amendamentuar për arsye se ka filluar Amendamenti i Ligjit për Mbeturina ("02/L-30"); I sponzoruar nga MMPH, me të cilin supozohet se KRM-të do të jenë nën autoritetin e plote të Komunave. Për këtë, ZRRUM ka vendosur që mos të filloj me amandamentimin e Ligjit Nr. 03/L-086, deri sa Ligji I Mbeturineve të kalon në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku saktësisht do të dihen kompetencat e ZRRUM-it, me qëllim që mos të ketë kohezion në mes Ligjeve.

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT DHE QARTËSIMI PËRGJEGJËSIVE INSTITUCIONALE**a) Sektori i Mbeturinave**

Ligji për Mbeturinat (nr. 02/L-030) përcakton se MMPH është autoritet përgjegjës për licencimin e personave juridik që menaxhojnë mbeturinat. Kjo bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit licencimi i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM. Komunitet në anën tjetër sipas Ligjit për Mbeturina janë përgjegjëse për administrimin e mbeturinave në territorin e vet dhe për përcaktimin e tarifave për shërbimet e mbeturinave. Edhe kjo përgjegjësi e komunitet bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM.

Këto kundërthënie janë eliminuar në një masë me Rregulloren 2006/31 me të cilën është dekretuar Ligji për Mbeturinat dhe e cila e ka konfirmuar përgjegjësinë e ZRRUM për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave. Megjithatë, është e nevojshme që të harmonizohen këto dy Ligje, me qëllim të evitimit të paqartësive sa i përket rolit dhe përgjegjësisë institucionale në sektorin e mbeturinave.

Përderisa nuk ndodhë ky harmonizim, ZRRUM e zbaton përgjegjësinë e vet në bazë të Ligjit nr. 03/L-086 për licencimin e kompanive publike të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave si dhe për përcaktimin e tarifave për kompanitë publike të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.

ZRRUM do të filloj me Draft Ligjin Për Ujësjellës (me apo pa Mbeturina), menjëherë pas aprovimit të Ligjit të Mbeturinave nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

(ii) Amandamentimi i Legjislacionit Sekondar – Rregullat e ZRRUM

Në janar të vitit 2005, ZRRUM ka nxjerrë 14 akte nënligjore (Rregulla) në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2004/49 të cilat Rregulla më detajshme i rregullojnë aspektet e caktuara që janë në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësisë të tij si: licencimi, tarifat, standardet e shërbimit, karta e konsumatorëve, shkyçja etj.

- Është Amendamentuar Rregulla për Kartën e Konsumatorëve, për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë ("R04/U&K") dhe
- Rregulla për Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë ("R05/U&K"), të cilat janë finalizuar në muajin korrik 2010.
- Draftimi dhe finalizimi i Marrëveshjes së Shërbimit në mes KRU dhe Komunave, ku shumica e Komunave e kanë nënshkruar por disa nga to ende hezitojnë
- Draftimi dhe finalizimi i Kontratave të Shërbimit, të cilat duhen të nënshkruhen nga ana e konsumatorëve dhe ofruesit të shërbimeve

(II) Përtëritja – Licencimi i Ofruesve të Shërbimit

Një ndër aktivitetet e rëndomta të ZRRUM, është Përtëritja- Licencimi i Ofruesve të Shërbimit, e cila bëhet në pajtim me Ligjin, Rregullat dhe procedurat e brendshme të ZRRUM.

Në vitin 2010, është përtëri Licenca e Shërbimit për 7 KRM, për periudhën 01/12/2010 – 30/11/2011.

Edhe pse KRM, me rastin e dorëzimit të aplikacionit nuk e kanë plotësuar kushtin e pagesës së taksës së licencimit ndaj ZRRUM, Licencat e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave janë lëshuar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, me kushte plotësuese nga arsyeja:

- E mos qëndrueshmërisë financiare të Kompanive respektive,
- Duke pasur parasysh Vizionin dhe Misionin e ZRRUM,
- Mbrojtjen e mjedisit,
- Mbrojtja e shëndetit të qytetarëve,
- ZRRUM në pajtim me nenin 7.4 të Ligjit, nuk mundë të siguroj se ofrimi i shërbimeve nuk do ti ndërpritet konsumatorëve në rast se Kompanitë respektive nuk do të licencohen.

(III) Masat sanksionuese-Paralajmërimet

KMDK është gjobitur nga ZRRUM me Vendim nr. 426 i dt. 26/10 në vlerë prej 5.000.00 € për deponimin e mbeturinave veçanta pa pasur licencë të shërbimit e cila është në procedurë ankimore edhe gjatë vitit 2011. Ky proces nuk ka mundur të përfundoj nga arsyeja se pala e pakënaqur ka parashtruar ankesë Komisionit Shqyrtues të ZRRUM në pajtim me nenin 34 të Ligjit dhe Këshillës juridike të Vendimit. Komisioni i cekur nuk është formuar për shkak të rrethanave aktuale politike në vend (përgjigjja e Kuvendit të Kosovës, nr. 03/4684/Do-2669/1 i dt. 18/11).

Gjatë 2010 janë Paralajmëruar gjithsejtë 12 Kompani, 4 për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit, 8 për Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave dhe 2 për Ofruesin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave.

Gjitha Kompanitë e Paralajmëruara kanë parashtruar Deklarata (në pajtim me nenin 33.1. iv të Ligjit) me të cilën kanë bind dhe arsyetuar ZRRUM, për dështimin e këtij obligimi Ligjor.

4.2. MBËSHTETJA INSTITUCIONALE NGA DONATORËT

ZRRUM ka ndërtuar raporte të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me të gjitha institucionet donatore në Kosovë. Në këtë kontekst, deri në Qershor 2010 ka vazhduar *përkrahja e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (SDC)*, në kuadër të projektit i cili ka filluar në janar të vitit 2008.

Gjatë kësaj periudhe, projekti në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Departamentit të Performancës në ZRRUM, ka realizuar aktivitetet në vijim:

- Përgatitjen e fletës së të dhënave, e cila përfshinë 70 të dhëna që kërkohen të raportohen nga Kompanitë e Ujit në ZRRUM në baza mujore dhe vjetore.
- Zhvillimin më tutje të sistemit të përpunimit të treguesve të performancës (OFCR), i cili i shërben ZRRUM për monitorimin e performancës së Kompanive të Ujit.
- Auditimin/verifikimin e të dhënave operative, financiare, dhe shërbimit me konsumatorë, të raportuara nga Kompanitë e Ujit.
- Shkruarjen e 16 Raporteve të auditimit/verifikimit të të dhënave të raportuara.
- Verifikimin në teren të të dhënave për leximin e ujëmatësve.
- Shkruarjen e 4 Raporteve të verifikimit të të dhënave të leximit të ujëmatësve (për KRU Gjilan, KRU Bifurkacioni, KRU Mitrovica, KRU Prishtina).

Në anën tjetër, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) e ka mbështetur aplikacionin e ZRRUM të bërë në vitin 2009, për mbështetje institucionale të ZRRUM gjatë viteve 2010- 2012.

Projekti ka filluar me 31 Maj 2010. Financohet nga BE, menaxhohet nga ZNKE, dhe implementohet nga konzerciumi IPA-as.

Gjatë periudhës së parë 7 mujore të vitit 2010, projekti ka punuar për së afërmi me personelin e ZRRUM, posaçërisht me departamentet e tarifave dhe performancës (e po ashtu edhe me dy përfituesit tjerë e që janë shtatë KRU si dhe NJPMNP të MEF) në dorëzimin e livrimeve kryesore të projektit të dhëna në vijim:

- Rishikimi i Politikës aktuale Tarifore për furnizim me ujë duke përfshirë edhe komponentin e ri të Politikës Tarifore për Ujëra të zeza
- Zhvillimi i draft Udhëzimeve për Planifikim të Biznesit për KRU
- Zhvillimi i draft Planit Monitorues Vjetor për ZRRUM
- Zhvillimi i Modelit të ri të Planifikimit të Biznesit
- Zhvillimi i planit për Faturimin e Konsumatorëve pa Ujëmatës
- Zhvillimi i Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator
- Rishikimi i Rregullave aktuale të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve
- Zhvillimi i Kalendarit Rregullator për procesin tarifar i cili do të fillojë në Qershor 2011 i aplikueshëm për periudhën trevjeçare 2012-2014
- Zhvillimi i draft raportit të detajuar në lidhje me atë se si mund të përmirësohet Efiçienca në Arkëtim nga KRU
- Mbështetje për ZRRUM në përgatitjen e Raportit Vjetor mbi Performancën e Kompanive për vitin 2009
- Nëntë punëtori interne janë zhvilluar për personelin e ZRRUM/KRU e kjo për t'i njoftuar në lidhje me komponentët e projektit (TeR në përgjithësi, Planifikimi i Biznesit për KRU, Formatimi i Raporteve të ZRRUM, Metodologjia Tarifore, Modeli për Planifikim të Biznesit për KRU, UKRR për ZRRUM, UKRR për KRU, Konsumatorët pa Ujëmatës, Taksat për Zhvillim Infrastrukturor)
- Janë zhvilluar dy punëtori të jashtme (mbajtur në datën 30 Shtator 2010, e cila u morr me rishikimin e performancës së Kompanive Regjionale të Ujit (KRU) në vitin 2009 .
- Po ashtu është ofruar mbështetje Ad hoc për ZRRUM në lidhje me çështje urgjente sipas kërkesës së Drejtorit të ZRRUM
- Deri në fund të muajit dhjetor 2010 në projekt janë angazhuar 8 persona, ndërkombëtarë dhe vendas, të cilët kanë punuar në zyre të ZRRUM, në afate të shkurtra dhe të gjata.

5. Relacionet e Jashtme

5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË

Në pajtim me orientimet strategjike të ZRRUM për bashkëpunim të hapur dhe të mirëfilltë me të gjitha palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë, e me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për arritjen e përmirësimeve të nevojshme në këta sektorë, ZRRUM edhe në vitin 2010 ka vazhduar qasjen e tij të hapur dhe bashkëpunuese me rregullatorët tjerë të këtyre sektorëve, si dhe me palët tjera të interesit.

(i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në fushën e monitorimit të standardeve të kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

Përpos takimit të rregullt vjetor që kemi pasur në muajin shkurt, bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e rregullt të informacioneve me interes të dy palëve. Në këtë plan, në Raportin Vjetor të Performancës 2009 për kompanitë e ujësjellësit, ZRRUM ka shfrytëzuar të dhënat e IKSHPK. Rrjedhimisht në bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK (si dhe MMPH, SHUKOS, donatorët) kemi shpallur kompaninë më të mirë të ujësjellësit për vitin 2009 dhe kemi organizuar ceremoninë e ndarjes së çmimeve në muajin shtator 2010. ZRRUM është i përkushtuar që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

(ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë dhe si rregullator mjedisor i sektorit të ujit dhe mbeturinave, ZRRUM edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH në sektorët e ujit dhe mbeturinave.

ZRRUM ka pasur disa takime me Ministrin e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave dhe në veçanti atë të mbeturinave dhe me këtë rast janë diskutuar edhe çështjet që lidhen me harmonizimin e legjislacionit në këta sektorë me qëllim të përcaktimit të qartë të rolit dhe përgjegjësi institucionale në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

(iii) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MEF

Pas marrjes së përgjegjësi nga MEF, respektivisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) e MEF-it në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrje publike qendrore.

Gjatë vitit 2010, kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta, duke përfshirë edhe workshope, dhe Udhëheqësi i NJPM, është edhe anëtar i Këshillit Drejtues në Projektin tonë dyvjeçar, e kjo me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët, dhe avancimit pozitiv të Kompanive Publike.

(iv) Bashkëpunimi me Palët tjera

Në vitin 2010, ZRRUM ka bashkëpunuar edhe me palët tjera të interesit, në kuadër të domenit të përgjegjësi të veta. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me:

- Ministrinë për Integrime Evropiane (MIE) në lidhje me hartimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), si dhe raportim për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asocimit (DPSA).
- Bashkëpunimi me Task Forcën e Ujit (TFU) në lidhje me Adresimin e krijimit të Politikave për Subvencionimin e Rasteve Sociale etj.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH), në aspektet e resurseve ujore, Amandamentimin e Ligjit të Mbeturinave.
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM).
- Asociacionin e Komunave të Kosovës; dhe me
- Përfaqësuesit e donatorëve (ZNKE, USAID, KfW, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë.

Me të gjitha këto palë, qoftë në takime të drejtpërdrejta apo në punëtori dhe konferenca, janë diskutuar zhvillimet në sektorët e ujit dhe mbeturinave dhe është paraqitur qëndrimi i ZRRUM lidhur me problemet aktuale në këta sektorë.

5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË

Bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujërave, ZRRUM e konsideron me rëndësi vitale, për shkëmbimin e përvojave dhe për adoptimin e praktikave të mira në fushën e zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit.

- Në këtë plan, në vitin 2010 ZRRUM ka vazhduar të bashkëpunojë me rregullatorin ekonomik të shërbimeve të ujit të Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i iniciuar më herët, e që është formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Kemi pasur një vizitë pune, dhe shkëmbim të stafit.
- Në anën tjetër, bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë i iniciuar në fund të vitit 2007, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe me shkëmbimin e Raportit Vjetor të Performancës 2009 të Kosovës, respektivisht Portugalisë. Në vitin 2010 kemi pasur një takim me përfaqësuesin e Portugalisë, gjatë takimit me ERRU, gjatë vizitës së punës në Shqipëri.

5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

Duke pasur parasysh faktin se koncepti i rregullativës ekonomike të shërbimeve publike është koncept relativisht i ri në Kosovë dhe rrjedhimisht njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve Kosovare dhe publikut të gjerë për këtë koncept janë mjaft të kufizuara, ZRRUM në vitin 2010 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjerë për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUM. Kryesisht përmes komunikatave për Shtyp si dhe të gjitha informacioneve që janë publikuar në Ueb Faqen e ZRRUM-it.

6. Aspektet Financiare

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUM janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kriterëve vijuese:

- të hyrat nga këto taksa duhet të korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUM për vitin aktual, me kusht që
- lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Po ashtu, projekte dhe aktivitete të caktuara të ZRRUM mund të financohen nga donacionet e agjencive donatore si dhe nga grantet qeveritare.

Buxheti vjetor i ZRRUM aprovet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e parashikimit të shpenzimeve të veta ZRRUM udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të mos ketë kosto të lartë për konsumatorët.

6.1. SHPENZIMET

Edhe pse ZRRUM të gjitha transaksionet financiare i kryen përmes barazimeve mujore të sistemit të Thesarit, ZRRUM mban kontabilitetin e vet financiar dhe material.

Për vitin fiskal 2010, ZRRUM ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 342,112.00 EUR, prej të cilave: 314,749.00 EUR të alokuara nga BKK .

Në tabelën më poshtë (Tabela 26) është dhënë një pasqyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUM në vitin fiskal 2010 si dhe shpenzimeve të realizuara.

Tabela 26: Buxheti i ZRRUM për 2010

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	158,930.00	153,381.00
Mallra dhe shërbime	176,532.00	157,089.00
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,650.00	4,279.00
Total Buxheti	342,112.00	314,749.00

ZRRUM buxhetin e vitit 2010 e ka shpenzuar ne % 92.00%

6.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT

Duhet të theksohet se përpos këtyre mjeteve, ZRRUM në vitin 2010 ka pasur mbështetje institucionale nga donatorët (SDC deri në qershor 2010) në formën e asistencës teknike. Prej datës 16 korrik 2010, ZRRUM ka pasur mbështetje nga projekti i IPA 2010 në vlerë prej 1.8 mil.€, (të cilat ZRRUM nuk i posedon meqenëse menaxhimi financiar i projekteve është bërë nga vet donatorët).

6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2010

ZRRUM për vitin 2010 ka planifikuar të inkasoj 349.040.00 euro nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, prej të cilave ka inkasuar 267.331.00 euro apo në % ka inkasuar 76.59% të të hyrave të planifikuara.

Krahasuar me vitin 2009 ZRRUM ka inkasuar 36.636.00 euro më shumë apo në %13.71%.

Vlen të theksohet se ZRRUM për vitin 2010 nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit ka inkasuar 100% të taksës së licencimit të planifikuar për vitin 2010, ndërsa te kompanitë e licencuara për grumbullimin e mbeturinave edhe pse është arritur një ngritje prej 10.46% krahasuar me vitin 2009 ku shkalla e inkasimit ka qenë 2%, nuk jemi të kënaqur.

Tabela 27: Pagesa e Taksës së Licencimit nga Kompanitë e Mbeturinave

Emri i Kompanisë	Rgjioni	Taksa Vjetore	Taksa Mujore	Total të paguara	Borgji për 2010
KRM "HIGJIENA" SH.A	GJILAN	10,824.68	902.06	3505.06	7,319.62
KRM "EKOREGJION" SH.A	PRIZREN	18,940.57	1,578.38	000	18,940.57
KRM "PASTRIMI" SH.A	PRISHTINË	38,674.81	3,222.90	3,222.90	35,451.91
KRM "AMBIENTI" SH.A	PEJË	10,571.00	880.92	1,761.84	8,809.16
KRM "UNITETI" SH.A	MITROVICË	12,209.89	1,017.49	1,017.49	11,192.40
KRM "PASTERTIA" SH.A	FERIZAJ	10,547.44	878.95	878.95	9,668.49
KRM "ÇABRATI" SH.A	GJAKOVË	5,012.46	417.71	1,670.84	3,341.62
Kompania "KMDK" SH.A	PRISHTINË	9,883.32	823.61	2,650.83	7,412.49
Totali:		116,664.17	9,722.01	14,527.91	102,136.26

Nga Planifikimi i inkasimit të taksës së licencimit për vitin 2010 nga kompanitë e licencuara për grumbullimin e mbeturinave në vlerë prej 116,664.17 euro ZRRUM ka inkasuar 14,527.91 euro apo në % 12.46%.

Arsyeja e mos inkasimit të taksës së licencimit nga ana e ZRRUM-it ka qenë shkalla shumë e ulët e inkasimit të këtyre kompanive, neglizhenca ndaj ZRRUM-it, Amandamentimi i ligjit të mbeturinave (i cili krijon mëdyshje të këto kompani), si dhe vështirësitë e tjera financiare që po i përcjellin këto kompani.

Borxhlinjtë e ZRRUM-it për vitin 2010

Borxhlinj të ZRRUM-it për vitin 2010 janë të gjitha kompanitë e licencuara që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Për vitin 2010 KRM Ekoregjioni nuk ka bërë asnjë pagesë .

ASETET E ZRRUM

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, pastaj Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetëm e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve në ZRRUM që nga viti 2005 e deri me 31.12.2010 ka arritur në: **96,582.00 EUR**.

Tabela 28: Vlera e Aseteve të ZRRUM

Nr.	Lloji i Aseteve	Vlera e Aseteve
1	Vetura	74,012.00€
2	Inventar, Pajisje, TI etj.	22,570.00€
Total:		96,582.00€